Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agim Sheqiri	**11.08.2023**	**18.08.2023**	**2023/0556**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.08.2023, OE "FORTESA SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0556, , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **GOE;ISEFERI SH.P.K&KAB HOLDING SH.P.K**, , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i rruges Velezh-Smaç" me nr. të prokurimit: "622-23-6163-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur kontrate per pune me vlerë të parashikuar e kontratë: 263,000.00 €.

.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ndërtimi i rrugës Velezh-Smaç

Në aktivitetin e prokurimit ne fjale ne si kompani ishim me çmimin ekonomikisht me te favorshëm dhe konsiderojmë qe AK ka bere shkelje ligjore dhe diskriminim ndaj kompanisë tone pasi qe arsyetimet e paraqitura për eliminim janë te pa baza dhe tendencioze.

Me date 25/07/2023 ne si OE kemi paraqitur ankesën pranë AK duke i ofruar faktet për mos trajtim te barabarte dhe shkeljet ligjore te cilat na jane bere neve si OE duke na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit por përgjigjja e AK ishte po e njëjta me atë te njoftimit për vendim, pra edhe pse ankesa jone kishte baze ligjore dhe dokumentohej me fakte, kjo ankese nuk është

përfillur nga AK.

O Neni 1 par. 1 dhe 2 të LPP-së ;

O Neni 2 të LPP-së;

O Neni 6 të LPP-së;

O Neni 7 të LPP-së;

O Neni 24 par. 2 dhe 3 të LPP-së;

O Neni 51 par. 1 dhe 2 te LPP-së;

O Neni 56 paragrafi 1.1; 1.2dhe paragrafi 3të LPP-së;

O Neni 59 par. 2 dhe 4 të LPP-së;

O Neni 60 par. 1.1 te LPP-së;

O Neni 38 i Rregullores 001/2022 për PP;

O Neni 40 i Rregullores 001/2022 për PP;

O Neni 45.17 i Rregullores 001/2022 për PP;

O Nenin 108/A par. 9 dhe 12 i LPP-së

Kërkesa 1. Projekte tengjashmetenatyrëssë kontratësrealizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluarnga koha e publikimittekëtijnjoftimi) e vërtetuarnga OE, kupërfshihentitujt e projekteve, numri, data e kontraktimitdhevlerat e tyre. Vleraminimale e tegjithaprojektevetënatyrës se kontratësduhettëjetë jo ma e vogël se 390.000,00 €.

(Mungojnë referencat e natyrës se kontratës keni vetëm 1730.000 mijë euro referenca te asfaltit jo sa vlera e kërkuar ne DT dhe NJK)

Përkundër këtij arsyetimi nga AK i cili është ne kundërshtimi me kërkesat e DT dhe NJK pasi që AK-ja, nuk ka specifikuar se cilat janë ato kontrata që nuk janë pranuar nga AK - Komisioni i vlerësimit, dhe qe arrijnë vlerën qe ata e kanë mendje POR PËR NE ËSHTË SHUMË E PA QARTË SEPSE ËSHTË SHKRUAR 1730.000 MIJ EURO; pra AK - Komisioni i vlerësimit, ZPP kanë qenë te obliguar te specifikojnë cilat janë ato projekte - Kontrata dhe sa është vlera e saktë sipas tyre!?,,,,,,,,,,gjë dëshmon se nuk ka respektuar nenin 6, dhe nenin 7 te LPP-së, dhe me këto veprim po ashtu ke shkelur edhe nenin 59 (konkretisht nenin 59par. 4 te LPP-së) dhe 60 te LPP-së.

Gjithashtu, duke ju referuar kërkesave mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, lidhur me projektet e ngjashme te natyrës se kontratës, ku bëjnë pjese ne ndërtimin e ulet, ku përveç rrugëve hyjnë edhe kanalizimet, ujësjellësi, kanalizimi atmosferik,

ndërtim dhe rehabilitimi i rrugëve plotësojnë kërkesën e AK, mirëpo marr per baze listën e kontratave te prezantuar nga ana jone dhe procesverbaleve te pranimit teknik atëherë shume qarte dëshmohet se kemi arrit te plotësoj ne tërësi këtë kërkesë te përcaktuar nga AK - ZPP ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate.

Sepse Ne si OE, përmes ofertës me rastin e tenderimit lidhur me ketë projekt kemi dorëzuar listën e kontratave te nënshkruar dhe te vulosur duke prezantuar 14 kontrata re realizuar duke ju bashkangjitur referenca dhe raporte te pranimeve teknike përfundimtarë ne vlere totale: 2,634,413.21 €, qe do te thotë se AK - komisioni vlerësimit ne kundërshtim me nenin 59 par. 4 të LPP-së, na eliminon nga ky AP pa arsyetuar dhe sqaruar se cilat janë ato projekte/kontrata edhe pse ne kërkesën tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 te FDT-se ka kërkuar projekte te ngjashme te realizuar te dëshmuar me referenca dhe pranime teknik përfundimtare, dhe duke marr per baze dokumentet qe ne kemi dorëzuar me rastin e tenderimit ne ketë tender përmes platformës elektronike e-prokurimi dëshmohet se ne kemi arritur te plotësojmë këtë kërkese 1 /Dëshmia 1 të FDT-së, sepse përveç projekteve te ngjashme ne kemi edhe projekte te natyrës se kontrate poz. 4, 5, 6, 8, 9, 14, dhe 15 ne listën e kontratave te prezantuar nga ana jonë janë kontrata te natyrës se këtij aktiviteti te prokurimit ku arrin vlerën: 619,947.81 € dhe arrijmë te plotësojmë ne tersi kërkesat e dosjes se tenderit dhe NJK dhe plotësojmë kriterin kryesor te përcaktuar ne dosje te tenderit neni 30.1 kriterin e dhënies s kontratës ku ne pajtim me nenin 60 par. 1 pika 1.1 të LPP-së, ku AK është dashur dhe ka qene i obliguar te na rekomandoj per dhënie tekontratës ne pajtim me kriteret e përzgjedhjes ne dosjen tenderit dhe dispozitat ligjore te LPP-së.

AK - ZPP me rastin e eliminim dhe arsyetimet e dhënë ne letrën standarde te eliminimi tone kane shkelur nenin 56 par. 3 te LPP-së, sepse shumë qartëështë kërkuar ne DT dhe NJK ku është kërkuar pune te ngjashme ne FDT, ndërsa nëse analizohet lista e kontratave te prezantuar nga ana jone si dhe kontratat, referencat dhe pranimet teknik vërehet se plotësohet kriteri i dosjes se tenderit ne tërësi, pasi qe kontrate e prezantuar ndërtimi i rrugëve sigurisht se ka edhe afelët (dhe ne jemi te specializuar per këtë natyrë te punëve dhe kemi edhe disa kontrata te ekzekutuar me AK po te kësaj natyre), prandaj AK nuk ka kërkuar ne dosje tenderit se pranohet vetëm kontratë per asfalt, qe vërtetohet se AK me rastin e eliminimit dhe refuzimit te kërkesë per rishqyrtim ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-së, duke na eliminuar ose përjashtuar nga procedurat e këtij aktiviteti te prokurimit në baza të ndonjë kërkese (arsyetimi se nuk kemi kontrata asfalti) ose kriteri që nuk është cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Pretendimi ankimore 2.

Ne letrës standarde te eliminimit kundrejt ofertës sonë AK - ZPP kane arsyetuar duke potencuar se:

"Ju mungojnë : Pajisjet teknike ; mungon grajderi , nuk keni prezantuar ne dokumente; Është vetëm

kontrata e shitblerjes jo dhe DuD;

Duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, ku ne kemi tenderuar, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si ne vijim:

Kërkesat:

Kërkesa 4. Të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a. 2 kamion të tonazhit me peshë ngarkuese mbi 10 ton, b. 1 bager mbi 10 ton, c. 1 cilinder për ngjeshje, e. 1 grajder per rafshim,f. 1 finisher. Në rast të krijimit të konsorciumit, OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % lërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës si dhe numrit të punëtoreve.

Evidencat:

Dëshmia 4 a, - të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, Dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë. b, c, e, f, duet te dëshmohet me DUD. ose kontratë shitblerje. Dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë.

Bazuar ne formularin e tenderit dhe dokumentet qe kemi ngarkuar lidhur me këtë pajisje ne platformën elektronike, ne kemi dorëzuar Kontratën e shitblerjes, duke plotësuar kërkesën4/deshmin4 si më lartë te përcaktuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate, ne asnjë rrethanë nuk përcaktohet se duhet te dëshmohet edhe me DUD doganore, pasi qe dëshmia ka qene: "DUD ose kontrate te shitblerje" qe do te thotë se njëra nga këto dy dokumente e plotëson kërkesën e FDT-se, prandaj ne kemi dorëzuar kontratën e shitblerjes per GREDER per rrafshim dhe kemi plotësuar këtë kërkesë te dëshmitë teknik dhe profesionale, mirëpo me arsyetimin e dhënë nga AK - komisioni vlerësim se na mungon DUD është ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se, konkretisht neni 7 par. 1dhe 2 te LPP-së, si dhe neni 56 par. 3 te LPP-së, e po ashtu nenin 59 par. 4 te LPP-së.

Prove: Kontrata e shitë-blerjes, dhe fletëpagesa përmes Bankës

Ne si OE, përmes ofertës kundrejt pajisjeve - Grejderit i kemi prezantuar te gjitha dëshmitë mbi pajisjet dhe makineritë kontratën e shite-blerjes dhe pagesën përmes bankës qe dëshmon pronësinë tone mbi këtë pajisje si dhe , referencat për punët paraprake te realizuara, dëshmitë përmes te cilëve vërtetohet se ne si OE, kemi arritur te plotësojmë te gjitha kriteret e përzgjedhjes, kriterin kryesor te shpërblimit - çmimin më te ulet te përgjegjshëm, dhe janë plotësuar te gjitha kërkesat dhe dispozitat ligjorë te LPP-së, qe te rekomandohemi per dhënie te kontratës ne këtë aktivitet te prokurimit!

Vëmendje: Duke marr per baze kërkesën4/dëshminë 4 te FDT-së, vërehet se është kërkuar grejder per rrafshim dhe nuk është specifikuar pesha/tonazha e kësaj pajisje, dhe dëshmia e kërkuar per këtë pajisje ne dosje te tenderit është Dud ose kontrate shitblerjes qe do te thotë cila do njëra këto dy dëshmi plotëson kërkesën e FDT-se, pasi qe ne kemi prezantuar kontratën e shitblerjes dhe pagesën e përmes bankës dhe argumentohet se jemi pronar i kësaj pajisje, mirëpo pavarishtë kësaj AK - ZPP komisioni i vlerësimit per çdo paqartësi kanë qen te obliguar te kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së.5epse ne jemi OE me çmimin me te ulet dhe te përgjegjshëm ne

funksionit te qëllimi dhe parimeve te LPP-se.

Por pavarësisht nga sqarimi ynë si më lartë ne konsiderojmë se kemi arrit te plotësojmë Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te vendosura nga AK - ZPP ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate, dhe janë plotësuar te gjitha kushtet dhe dispozitat ligjore qe te rekomandohemi per dhënie te kontratës lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, pasi qe kemi plotësuar edhe Kriteret e Dhënies - tenderi me çmimin më të ulët të përgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komuna Prizrenit për kontratë rekomandon GOE." ISEFERI SH.P.K&KAB HOLDING" SH.P.K ne vlere totale te ofertës prej 162.680.11 Euro, kundrejt OE ankues i cili kishte ofertuar me çmim prej 157,349.39. €

OE ankues sipas Letrës Standarde është eliminuar nga konkurrenca sipas arsyeve si ne vijim:

Ju mungojnë :

Kërkesa 1. Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve tënatyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 390.000,00 €.

Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo process verbal te pranimit përfundimtar të punëve.(Mungojnë referencat e natyrës se kontratës "referenca me asphalt" keni vetëm 1730.000 mijë euro referenca te asfaltit jo dhe sa vlera e kërkuar ne DT dhe NJK)

Pajisjet teknike ; mungon grajderi , nuk keni prezantuar ne dokumente; Është vetëm kontrata e shitblerjes jo dhe DuD;

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **FORTESA SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimet ankimore te OE ankues dhe njëkohësisht ka analizuar raportin vlerësimit dhe vendimin e AK-se lidhur me refuzimin kërkesës për rishqyrtim dhe sipas analizave dhe vlerësimeve rezulton se AK nuk ka ber vlerësim te ofertave ne përputhje me kërkesat e parashtruar ne njoftim per kontrate dhe dosje te tenderit për faktin se OE ankues i ka plotësuar kërkesat kualifikues ne përputhje me ato te kërkuar nga AK-ja

Sipas vlerësimeve te Ekspertit Shqyrtues te dy pretendimet ankimore janë te bazuar për faktin se :

AK ne dosje te e tenderit tek kritere kualifikuese per pretendimin nr. 1 që lidhet me qarkullimin ka kërkuar si ne vijim

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1. Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 390.000,00 €.

Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranim

OE ankues rastin e dorëzimit te ofertës ka dorëzuar ne liste me kontrata te realizuara ne vlere prej 2,634,413.21Euro ku përfshihen 15 projekt te realizuara ne periudhe te ndryshme kohore dhe me vlera te ndryshme.

Lista e kontratave të përfunduara së bashku me pranimet teknike ose referenca 2019,2020 dhe 2021

Nr.r.	Data 0 kontraktl mlt	Data e Pranimt teknlk	Datae References	Autoritetit Kontraktues	Emri l prcjoktft	Nr. Prokurlmtt	Vlerae kontraktimtt
1	01.10.2019	15.11.2019		K.K. Suharekë	Lot/pjesa 1 Ndërtimi I rrugës Sylë Duhla, Sadrl Guraziu, Ushtria e Kosovës dhe rrugët tjera në Bllacë.	624-19-1)61-521 624-19-5412-521	12,200.80 €
2	26.09.2017	09.03.2020	10.03.2020	K.K. Prizren	Rehabllitimi i ujësjelisave, kanalizimeve dhe pusetave (dhe rreugëve pas intervenimeve) në Komunën e Prizrenlt	622-17-3160-511	1,580,619.00 €
3	01.10.2019	15.11.2019		K.K. Suharekë	Ndërtimi i rrugëve lokale 7 Lot vazhdlmi- Lot 5 nd. Rr. Perespektlva Mustafaj.Rrustem Osmani	624-19-062-521 624-19-5399-521	26,859,05 €

4	08.11.2019	05.07.2020		K.K. Prizren	Ndërtimi I rrugëve lokale në Korishë të Prizrenlt	622-19-181-521	159,987.60 €
5	27.05.2020	05.07.2020		K.K. Prizren	Aneks - Ndërtlmi i rrugëve lokale në Korishë të Prizrenit	622-20-030-525	15.694.39 €
6	15.06.2020	18.09.2020		K.K. Prizren	Ndërtiml i infrastrukturës rrugore në nugën fehredin Hoti në Prizren	622-20-1810-5-2-1	173,460.93 €
7	25.08.2020	01.12^020		K.K. Prizren	Adap.Rr.l KomuniLRAE Rexhep Karaqi	622-20-2936-521	29,644.26 €
B	20.10.2020	21.12.2021		K.K.Prizren	Ndërtimi I rrugëve lokale në Lubizhdë të Prizrenlt	622-20-5545-5-2-1	237,324.63 €
9	29.10.2020			K.K. Suharekë	Ndërtimi 1 rrugëv lokale në Komune 4 Uot- Delloc, Dovoran, Popolan, Dubrave	624-20-2056-5-2-1	7,544.56 €
10	02.12.2020	24.11.2021		K.K. Prizren	Rehabilitlmi i kanalizimit dhe ujësjellësit (kanalizimi atmosferik, kanalizimi fekal dhe ujësjellësi)në rrugën Rugova dhe Nora	622-20-5978-5-2-1	159,824.70 €

					Kelmendi në Komunën e Prizrenit		
11	**05.11.2020**	**15.12.2020**		**K.K. Prizren**	**Ndërtiml i kanalizimit në rrugën Xhevat Bajraktari (lagj|a Tusus)**	**622-20-5695-521**	**13.394.40 €**
12	**12.11.2020**	**15.12.2020**		**K.K. Prizren**	**Ndërtimi i kanalizimit në rrugën Agim Shala (lagjja Kurilla)**	**622-20-6038-521**	**10,096.10 €**
13	**25.11.2020**	**03.12.2021**		**K.K. Prizren**	**Rehabilitimr i kanalizimit dhe ujësjellësit(kanalizlmi atmosferik .kanalizlmi fekal.dhe ujësjellësi) në rrugën e vjeter te Hoqës së Qytetit në Komunën e Prizrenit**	**622-20-5946-5-2-1**	**181,627.09 €**
14	**16.08.2021**			**K.K. Suharekë**	**Lot 2 Ndertimi i nugëeve Gani Kolgeci Popolan**	**624-21-526-5-2-1**	**14,053.20 €**
15	**14.10.2021**			**K.K. Suharekë**	**Ndertimi i rrugëve lokale 6 lot**	**624-21-6304-5-2-1**	**11,882.50 €**

Totall	**2,634,413.21 €**

Nëse marrim për baze projektet me nr. 8 dhe 10 te realizuar ku Autoritet Kontraktues ka qene Komuna e Prizrenit OE ankues përmbush kërkesën për qarkullim pa marre për baze projekt tjera te realizuar pasi qe vlera e këtyre projekteve te realizuara tejkalon vlerën prej 390, 000.00 Euro.

Gjithashtu edhe pretendimi i dyte është plotësisht i bazuar sepse ne dosje te tenderit tek kriteret kualifikues lidhur me pajisjet nga AK ka kërkuar nga OE te ofrojnë liste te pajisjeve te dëshmuara me kontrata te shitblerjes apo DUD doganor qe nënkupton se ka qene opcinale ofrimi i dëshmisë dhe ketë kërkesë OE e ka përmbush ne përputhje me kërkesat e dosjes madje e edhe ne arsyet e eliminimit theksohet se ka ofruar kontrate te shitblerje por jo edhe DUD doganor

OE ankues si dëshmi ofron kontratën për blerje te pajisjes -grejderit te datës 21.12.2020 dhe njëkohësisht ofron dëshminë lidhur me pagesën qe është bere per blerje te kësaj pajisje dhe kjo konsiderohet si dëshmi e mjaftueshme qe OE ankues posedon llojin makinerie te quajtur grejderë për rrafshim.

Eksperti vlerëson se Autoritet kontraktues lidhur me ketë aktivitet te prokurimit nuk ka bere vlerësim ne përputhje me kriteret e për caktua për kualifikim dhe kriterin e përcaktuar për vlerësim dhe me ketë rast rekomandon qe AK te anuloj vendimin e 21.07.2023 dhe aktivitetin prokurimit ta rivlerësoj

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **FORTESA SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Agim Sheqiri